

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**

Departamenti: Agroekonomi

Programi: Ekonomia e bujqësisë dhe ushqimit



DORËSHKRIMI I TEMËS SË MASTERIT

TEMA ME TITULL:

EKONOMIA QARKULLUESE DHE LINEARE NË KOSOVË

Kandidati:

Bsc. KadriCikaqi

Mentori:

Prof. Dr. MustafePllana

Prishtinë, Shtator, 2021

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**

Departamenti: Agroekonomi

Programi: Ekonomia e bujqësisë dhe ushqimit



DORËSHKRIMI I TEMËS SË MASTERIT

TEMA ME TITULL:

EKONOMIA QARKULLUESE DHE LINEARE NË KOSOVË

Kandidati:

Bsc. KadriCikaqi

Mentori:

Prof. Dr. MustafePllana

Prishtinë, Shtator, 2021

Falenderime

Ishte një rrugëtim i gjatë i cili ndonjëherë është përcjellë me vështirësi por ç'është më e rëndësishmja ka pasur shumë vlerë të madhe. Prandaj, nëse ne duam që të kemi sukses gjatë një rrugëtimit atëherë ne duhet të përkushtohemi plotësisht e të punojmë me shumë mund.

Në disa raste, kjo bëhet shumë më e lehtë duke pasur gjithmonë në krahë njerëzit e afërm e më të rëndësishëm.

Falenderoj nga zemra familjen time e cila ka qenë shtylla kryesore e zhvillimit tim gjatë gjithë këtyre viteve studimi, motivi i tyre, sakrificat e tyre për mua dhe ndihma ndaj meje kanë qenë motivimi im për të përfunduar studimet në kohën e duhur dhe në mënyrën e duhur.

Falenderimet e mija më të sinqerta, shkojnë edhe për profesorët me të cilët kam kaluar dy vite mjaftë të mira, stafin profesional, e në veqanti mentorin tim **Prof.Asoc.Dr. Mustafë Pllanai** cili ka bërë një punë të palodhshme në zhvillimin tonë si profesionist në këto dy vite. Mentorin e falenderoj përzemërsisht edhe për kohën e kushtuar ndaj meje si bartës i punimit.

Një mirnjohje të veçantë ua shprehim edhe kolegëve me të cilët kaluam dy vite të paharrueshme bashkë, shpresojmë të takohemi përsëri gjatë studimeve në nivele më të larta.

Dedikim

*Këtë punim dhe këtë arritje ia dedikojë dashurisë më të madhe të familjes sonë,
djalit të vëllaut tim **Diellit**, shpresojë dhe latem që ai të këtë jetë të gjatë dhe
të arrijë majat e suksesit e të këtë shumëfishin e sukseseve të mija.*

Deklarata e plagjiaturës

Unë KadriCikaqi , student i nivelit master në fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinaris , drejtimin Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit , në Universitetin e Prishtinës, deklaroj që punimin e diplomes e kam pregaditurpësonalisht, duke i referuar të gjitha burimet e përdorura dhe referencat e vendosura , duke deklaruar me përsosnalitetin tim që ky punim është i krijuar nga unë dhe vetëm unë.

Deklaroj:

KadriCikaqi

Përmbajtja

Abstrakti	8
Kapitulli I.....	10
I.Hyrje.....	10
II.Qëllimet e hulumtimit (hipotezat).....	11
III.Pyetjet kërkimore.....	12
Kapitulli II.....	15
1.Metodologjia e hulumtimit dhe rishikimi i literaturës.....	10
2. Ekonomia qarkulluese dhe lineare.....	16
2.1 Ekonomia qarkulluese.....	17
2.1.1 Pse na duhet ekonomia qarkulluese.....	19
2.1.2 Objektivat e ekonomisë qarkulluese.....	21
2.1.3 Ekonomia qarkulluese në fermat bujqësore.....	22
2.2 Ekonomia lineare.....	23
2.3 Analiza S.W.O.T për Ekonominë Qarkulluese kundrejt Ekonomisë Lineare.....	24
2.4 Zbatimi i ekonomise lineare dhe qarkulluese në bujqësi.....	25
2.4.1 Mbeturinat mund të bëhen burime.....	26
2.5 Zbatimi i ekonomise qarkulluese dhe lineare në industrin ushqimore.....	27
Kapitulli III.....	28
3. Industria ushqimore dhe ekonomia qarkulluese.....	29
3.1 Tretja anaerobe e mbeturinave të ushqimit.....	30
3.2 Si mund të përfitojnë bizneset Kosovare nga riciklimi i mbeturinave të ushqimit.....	31
3.3 Mënyrat që duhet përdorur për riciklimin e mbetjeve ushqimore.....	32
3.4Koha që u nevojitet materialeve të ndryshëm të dekompozohen.....	34
Kapitulli IV: Rezultatet e hulumtimit dhe diskutimi i tyre.....	40
5. Përfundimi.....	48
6. Rekomandimi.....	49
7. Literatura.....	50

Lista e figurave :

Figura 1. Ekonomia qarkulluese

Figura 2. Ekonomia lineare

Figura 3. Rrjedha lineare e sistemeve tradicionale të prodhimit

Figura 4. Rrjedha e një sistemi qarkullues ekonomik

Figura 5. Zbatimi i ekonomise lineare në industrin ushqimore

Figura 6. Zbatimi i ekonomise qarkulluese në industrin ushqimore

Figura 7. Procesi i tretjes anaerobe

Figura 8. Koha që u nevojitet materialeve të ndryshëm të dekompozohen

Abstrakti

Një ekonomi rrethore është thelbësisht e ndryshme nga një ekonomi lineare. Për ta thënë thjesht, në një ekonomi lineare ne nxjerrim lëndë të para që i përpunojmë në një produkt që hidhet pas përdorimit. Në një ekonomi rrethore, ne mbyllim ciklet e të gjitha këtyre lëndëve të para. Mbyllja e këtyre cikleve kërkon shumë më tepër sesa thjesht riciklim.

Sistemi rrethor dhe sistemi linear ndryshojnë nga njëri -tjetri në mënyrën në të cilën krijohet ose mbahet vlera. Një ekonomi lineare tradicionalisht ndjek planin hap-pas-hapi. Kjo do të thotë që lëndët e para mblidhen, pastaj shndërrohen në produkte që përdoren derisa të hidhen përfundimisht si mbeturina. Vlera krijohet në këtë sistem ekonomik duke prodhuar dhe shitur sa më shumë produkte.

Për një kohë të gjatë, ekonomia e Kosovës ka qenë 'lineare'. Kjo do të thotë se materialet e papërpunuara përdoren për të prodhuar një produkt, dhe pas përdorimit të tij çdo mbeturinë (p.sh. paketimi) hidhet. Vendi ynë tani ka filluar të marrë njëkahje të re të bazuar në riciklimin, ku materialet do të ripërdoren. Për shembull, mbetjet e qelqit përdoren për të bërë qelqe të reja dhe letrat e përdorura për të prodhuar letra të reja. Për të siguruar që në të ardhmen ka mjaft materiale të papërpunuara për ushqim, strehim, ngrohje dhe nevoja të tjera, ekonomia jonë duhet të bëhet qarkulluese. Kjo do të thotë të parandalosh mbeturinat duke i bërë produktet dhe materialet sa më efikase dhe duke i ripërdorur ato. Nëse nevojiten materiale të reja të papërpunuara, ato duhet të sigurohen në mënyrë të qëndrueshme që mjedisi natyror dhe ai njerëzor të mos dëmtohen.

Koncepti i ekonomisë qarkulluese ka bërë një kalim gradual nga kornizat teorike në botën e biznesit. Ky model ekonomik alternativ po shikohet si një zgjidhje e shumë sfidave, duke nisur që nga kushtëzimi i burimeve, rritja e konkurrencës apo paqëndrueshmërisë së tregjeve. Me gjithë "nxitim" për të kaluar në një model të tillë, përsëri kuptimi i konceptit mbetet i vakët.

Në këtë punim kryesisht është shtjelluar qështja e ekonomive qarkulluese dhe lineare për industrinë ushqimore dhe një pjesë të plastikës pasi janë dy nga fushat më të ndishme në vendin tonë pasi një masë e madhe e tyre nuk shfrytëzohet plotësisht por vetëm një pjesë e ciklit të jetës së tyre.

Fjalët kyçe : Ekonomia qarkulluese, ekonomia lineare, mbetje ushqimore , riciklim , cikli i jetës

Abstract

A circular economy is fundamentally different from a linear economy. Simply put, in a linear economy we extract raw materials that we process into a product that is thrown away after use. In a circular economy, we close the cycles of all these raw materials. Closing these cycles requires much more than just recycling.

The circular system and the linear system differ from each other in the way in which value is created or maintained. A linear economy traditionally follows a step-by-step plan. This means that the raw materials are collected, then turned into products that are used until they are finally disposed of as waste. Value is created in this economic system by producing and selling as many products as possible.

For a long time, Kosovo's economy has been 'linear'. This means that raw materials are used to produce a product, and after its use any waste (e.g. packaging) is discarded. Our country is now starting to take a new direction based on recycling, where materials will be reused. For example, glass scraps are used to make new glassware and the paper used to make newspaper. To ensure that in the future there is plenty of raw materials for food, shelter, heating and other needs, our economy must become circulating. This means preventing waste by making products and materials as efficient as possible and reusing them. If new raw materials are needed, they must be sustained to ensure that the natural and human environment is not harmed.

The concept of circular economy has made a gradual transition from theoretical frameworks to the business world. This alternative economic model is being seen as a solution to many challenges, ranging from resource conditioning, increased competition or market instability. Despite the "rush" to move to such a model, again the meaning of the concept remains lukewarm.

In this paper is mainly discussed the issue of circulating and linear economies for the food industry and part of plastic as they are two of the most sensitive areas in our country as a large part of them is not fully utilized but only part of the lifecycle of tire.

Keywords: Circulating economy, linear economy, food waste, recycling, lifecycle

KAPITULLI I

I.HYRJE

Thelbi i ekonomisë qarkulluese reflektohet në tendencën e njerëzimit të arrijë që ta minimizojë sistemin ekonomik, mbi të cilin funksionon natyra – ku lëndët e para që hyjnë në krijimin e një produkti në natyrë nuk humben, por vetëm transformohen nga një formë në tjetrën. Në përballje me mbipopullimin, stërpërdorimin e resurseve të kufizuara, degradimin ambiental dhe ndikimin në mirëqenien e njerëzimit, shihet qartë që sistemi ekonomik tradicional linear që filloi para disa qindra vitesh, dhe mori hov nga revolucioni industrial e tutje, nuk është i qëndrueshëm për të përballuar ndryshimet ambientale me të cilat do të ballafaqohet njerëzimi në të ardhmen.

Qëllimi i ekonomisë qarkulluese është të që ofrojë një zgjidhje me të favorshme në krahasim me ekonominë lineare, e cila bazohet në në sistemin tëshfrytëzohj burimet – tëprodhojm produkte – të i konsumojm ato – të i hudhim mbetjet se nuk na duhen më, drejt një sistemi ekonomik ku fokusi është përdorimi i burimeve deri në fund të jetës së tyre duke përdorur sistemin tëshfrytëzohj burimet – tëprodhojm produktet – të i konsumojm ato – të mos i hudhim mbetjet sepse mund të i ripërdorimin për prodhimin e produkteve shtesë. Qëllimi i ekonomisë qarkulluese është përdorimi i burimeve të cilat mund të ripërdoren dhe të ri-reciklohen në vazhdimësi. Ky sistem ekonomik në krahasim me atë linear ka për qëllim eliminimin e mbetjeve dhe përdorimin sa më efikas të resurseve për prodhim.

Koncepti i ekonomisë qarkore në shtetet në zhvillim është duke u studiuar dhe duke u testuar, me qëllim të arritjes së një shtate përmes këtij modeli ekonomik të sigurohet qëndrueshmëria e jetës njerëzore për një periudhë afatgjate.

Në Kosovë zbatim më tëmadhë ka gjetur ekonomia lineare që njihet ndryshe edhe si “sistemi ekonomik tradicional”, ku interesi i njerëzve është tëshfrytëzojn atë produkt aty per aty dhe të mos merren me riciklimin dhe ripërdorimin e saj, në krahasim me ekonomin bashkëkohore siç po cilësohet sistemi ekonomik qarkullues , ku burimet do të shfrytëzoheshin deri nëhallken e fundit tëzgjirrit të jetës së tyre. Ky sistem në Kosovë ende nuk është zhvilluar dhe shtrirë në tërësi pasi shumica e bizneseve nuk kan njohuri për këtë sistem dhe janë të kënaqur me sistemin e tanishëm pa e ditur se sistemi ekonomik qarkullues është shumëfish më i favorshëm dhe mëprofitabil.

II. Qëllimet e hulumtimit (Hipotezat)

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të gjejë pozicionin aktual të menaxhimit të inventarit dhe ndikimin e tij në profitabilitetin e kompanive prodhuese. Objektivat specifike janë:

- a. Të vlerësoj sistemin ekzistues të menaxhimit të inventarit në kompanitë prodhuese.
- b. Të identifikojë problemet me të cilat përballen kompanitë prodhuese në kohën e menaxhimit dhe kontrollit të inventarit.
- c. Të kontrolloj praktikën e menaxhimit të inventarit dhe ndikimin e saj në profitabilitetin e kompanive prodhuese.
- d. Të ofrojë sugjerime logjike bazuar në gjetjet e studimit.

Hipotezat në vijim janë zhvilluar për këtë studim:

H₁: Menaxhimi efikas i inventarit zvogëlon kostot gjatë prodhimit.

H₂: Menaxhimi efikas i inventarit ndihmon kompanitë prodhuese të jenë më konkurruese.

H₃: Menaxhimi efikas i inventarit ndihmon kompanitë të rrisin profitabilitetin e tyre.

III.Pyetjet kërkimore

Në kuadër të pyetjeve kërkimore pyetjet e ngritura kanë dhënë këto përgjigjeje:

1.Cilat janë pengesat që po e ngadalësojnë zhvillimin e ekonomisë qarkulluese në Kosovë ?

Përgjigjja e pyetjes kërkimore 1 - Duke dhënë përgjigjej për pyetjen e parë kërkimore mund të vërtetohet se pengesat që po e ngadalësojnë zhvillimin e ekonomisë qarkulluese në Kosovë janë:

- Mosdija e përgjithshme
- Mungesa e iniciativave shtetërore që stimulojnë sistemin ekonomik qarkullues
- Mungesa e iniciativës nga bizneset dhe qytetarët
- Mungesa e qasjes në dije për të mësuar për krijimin e bizneseve që ndihmojnë ekonominë qarkulluese
- Mosinteresimi i bizneseve për të punuar në zhvillimin e produkteve të reja

2.Cilat nga format e implementimit të ekonomisë qarkulluese do të ishin efektive për krijimin e kushteve të favorshme për lulëzimin e ekonomisë qarkulluese në Kosovë ?

Përgjigjja e pyetjes kërkimore 2 - Duke dhënë përgjigjej për pyetjen e dytë kërkimore mund të thuhet se format që do të ishin efektive për krijimin e kushteve të favorshme për lulëzimin e ekonomisë qarkulluese në Kosovë janë:

- Krijimi i ekosistemit financiar që siguron sukses në ekonominë qarkore
- Përgatitja e fuqisë punëtore dhe ndërmarrësve të krijojnë biznese në përputhje me kriteret e ekonomisë qarkulluese.
- Krijimi i modeleve stimuluese për qytetarët e zakonshëm të marrin pjesë në krijimin e ekonomisë qarkulluese.
- Krijimin e ekosistemit infrastrukturor që mundëson funksionimin e ekonomisë qarkulluese në vend

3.Sa do të jetë e vështirë kalimi nga ekonomia lineare në ekonomi qarkulluese në Kosovë?

Përgjigja e pyetjes kërkimore 3 - Duke dhënë përgjigje për pyetjen e tretë kërkimore mund të thuhet sëvështirësit më të mëdha për kalimin nga ekonomia lineare në atë qarkulluese janë:

- Mungesa e njohurive për rëndësin e ekonomisë qarkulluese
- Mungesa e teknologjive inovative të cilat mbështesin ekonomin qarkulluese
- Sistemi ekonomik i vendit tonë ku jemi të varur më shumë nga konsumi se sa nga ripërdorimi
- Mungesa e sistemit infrastrukturor që mundëson funksionimin e ekonomisë qarkulluese në vend
- Mungesa e ekosistemit financiar që mundëson funksionalizimin e ekonomisë qarkulluese

KAPITULLI II

1.METODOLOGJIA E PUNIMIT DHE RISHIKIMI I LITERATURËS

Për realizimin e këtij punimi, një vend të veçantë ka metodologjia e përdorur. Përzgjedhja e literaturës është një nga hapat parësor dhe të rëndësishëm pasi konsiston në indentifikimin dhe më pas rishikimin e literaturës ekzistuese në lidhje me objektin e studimit. Ajo përfshin studimin e librave, artikujve, kumtesave të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare.

Rishikimi i literaturës ekzistuese ka për qëllim përcaktimin e fushës së këtij studimi, por nga ana tjetër rishikimi i literaturës ndihmon në evidentimin e saj se çka është arritur dhe çfarë mbetet për tu arritur nëpërmjet thellimit të njohurive.

Literatura e përzgjedhur do të ndihmojë në strukturimin e përmbajtjes së koncepteve të nevojshme që përfshihen në këtë punim. Një tjetërndihmes do të jetë gjenerimi i pyetjeve kërkimore, një aspekt kyç i këtij kërkimi shkencor.

Faza e dytë është zgjedhja dhe përshkrimi i mostrës. Për realizimin e këtij studimi, faza empirike mbështetet në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave në terren në përmjet metodologjisë së hulumtimit.

Anketimi mbështetet në plotësimin e pyetjeve të të dhëna në një pyetësor të hartuar posaçërisht për këtë studim. Anketimi u zhvillua në tridhjetë ndërmarrje prodhuese të mesme dhe të mëdha në rajonin e Prishtinës, Prizrenit dhe Pejës, i cili kishte për qëllim mbledhjen e të dhënave reale. Të dhënat e mbledhura nëpërmjet pyetësorit do të grumbullohen dhe përpunohen me metoda statistikore.

Nocioni i njëekonomieqarkullueserethorebesohet se hapat e parëtëekonomisërrethorefilluannë fund të viteve 1970, me sinergjinë e të menduarit të shkencëtarëve dhe ekspertëve në shumë fusha. Ideja e materialeve qarkulluesesi model i ekonomisë u prezantuan në vitin 1966 nga K. E. Boulding në punimin e tij: Tokasiani jekonomike. Boulding, K. E. (1966)

Ekonomistët britanikë D. W. Pearce dhe R. K. Turner janë gjithashtu popullarizuar ekonomisë qarkulluese . të cilët në vitin 1989 në punimin e tyre mbi Ekonominë e Burimeve Natyrore dhe Mjedisit paraqitën një ekonomi rrethore të bazuar në studimin e sistemeve të jetesës reciproke

(jolineare). W. R. Stahel konsiderohet gjithashtu si një nga themeluesit e konceptit të ekonomisë rrethore .W. R. Stahel, arkitekti dhe ekonomisti që themeloi Institutin e Qëndrueshmërisë. Fokusi kryesor i Institutit Stahel ishte kërkimi në zgjatjen e jetës së produktit, rindërtimin dhe parandalimin e mbeturinave. Stahel thekson rëndësinë e ofrimit të shërbimeve, në vend të prodhimit të produkteve, e cila haset si një ide e quajtur "ekonomia e shërbimit funksional ose ekonomia e performancës".

Në 1976, WR Stahel së bashku me G. Reday në raportin e tij për Komisionin Evropian: Potenciali për Zëvendësimin e Fuqisë Njerëzore për Energji, përvijoi një vizion të një ekonomie me qark të mbyllur dhe ndikimin e saj në krijimin e vendeve të punës, konkurrencën ekonomike, kursimin e burimeve dhe parandalimin e mbeturinave .

Më vonë, në vitin 1982, raporti u përkthye në librin Punë për nesër: Potenciali për zëvendësimin e fuqisë punëtore me energji.

S. D. Parker në vitin 1982 hulumtoi dhe paraqiti mbeturinat si një resurs (burim) në sektorin bujqësor në Mbretërinë e Bashkuar, duke zhvilluar sisteme të reja të prodhimit me qark të mbyllur që imitojnë dhe integrojnë ekosistemin natyror. Zhvillimi i mëtejshëm i kësaj ekonomie u ndikua nga kimisti gjerman M. Braungart dhe arkitekti amerikan B. McDonough, të cilët vazhduan të zhvillojnë konceptin e Cradle to Cradle Djepit ("djep në djep") dhe zhvilluan procesin e certifikimit të produkteve. EllenMacArthurFoundation, (2010)

Në punën e tyre ata flasin për dy lloje të metabolizmit: biologjik (lëndë e biodegradueshme) dhe teknologjike (çështje teknologjike). Në mënyrë që këto dy metabolizma të mbeten të shëndetshëm, ata duhet të qëndrojnë të ndarë dhe të mos kontaminojnë njëri -tjetrin. Substancat biologjike hyjnë në ciklet natyrore ku do të ketë ushqim për mikroorganizmat, dhe përbërësit teknologjikë qarkullojnë brenda disa cikleve industriale.

Fondacioni EllenMacArthur, një organizatë e pavarur humanitare e themeluar në vitin 2010 me qëllim të inkurajimit të kalimit në një ekonomi rrethore, gjithashtu luajti një rol të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë qarkulluese. Fondacioni ka krijuar një platformë globale për informimin, mësimin dhe inkurajimin e aplikimit të ekonomisë qarkulluese. Ai gjithashtu bashkëpunon me qeveritë e vendeve të ndryshme, sektorin e biznesit dhe akademikët në

fuqizimin e inovacioneve të biznesit që zbatojnë këtë koncept të ekonomisë. EllenMacArthurFoundation, (2010)

2.EKONOMIA QARKULLUESE DHE LINEARE

Produktet që ne përdorim për të gjitha aspektet e jetës shpesh projektohen dhe prodhohen duke mos menduar se burimet janë të kufizuara kurse nevojat e pakufizuara , dhe nuk mendohet fare se si të rigjenerohen ato burime apo çfarë u ndodh atyre produkteve në fund të jetës së tyre. Përveç blerjeve më të shtrenjta që bëjmë, si një makinë apo shtëpi, kur diçka prishet në botën tonë moderne shpesh është më e kushtueshme për të riparuar sesa për të blerë një të re, dhe zakonisht ato të vjetrat dhe të dëmtuarat shkojnë në deponi. Ta themi thjesht, këto produkte nuk janë të dizajnuara për ripërdorim, riparim, rikonstruksion ose për t'u riprodhuar. Ky grup i njerëzve me mendje të tillë *bleje – shfrytëzoje – hudhe* , ka krijuar ekonominë lineare.

Për 250 vitet e fundit, ekonomitë në botën e zhvilluar janë bazuar në një model linear të rritjes së vazhdueshme, duke u mbështetur në burimet natyrore të botës për ta bërë jetën tonë më të shëndetshme, më të pasur dhe më të rehatshme.

Por bota jonë tashmë po tregon streset dhe sforcimet e këtij modeli "marr, bë, harxho". Kjo është arsyeja pse ne po shkojmë drejt një ekonomie rrethore, të bazuar në produkte me jetë të gjatë që mund të rinovohen, ripërdoren, riparohen, azhurnohen dhe rinovohen për të ruajtur burimet e çmuara natyrore, për të mbrojtur habitatet dhe për të zvogëluar ndotjen.

Një ekonomi qarkulluese është një alternativë ndaj ekonomisë tradicionale lineare në të cilën ne i mbajmë burimet në përdorim për aq kohë sa të jetë e mundur, nxjerrim vlerën maksimale prej tyre, pastaj rikuperojmë dhe rigjenerojmë produkte dhe materiale nga mbetjet duke shfrytëzuar maksimalisht ciklin e jetës së tyre.

Kur një produkt është krijuar për përdorim më të gjatë të mundshëm dhe mund të riparohet lehtë, të prodhohet ose riciklohet (ose të përdoret, të kompostohet dhe lëndët ushqyese të kthehen), ne e konsiderojmë atë të ketë një cikël jetësor qarkullues apo si një ekonomi qarkulluese.

Një ekonomi qarkulluese ushqehet nga energjia e rinovueshme (p.sh. dielli, uji, era etj.).

2.1 Ekonomia qarkulluese

Ekonomia qarkulluese merr në konsideratë proceset e prodhimit dhe përshkruan mënyrën e ripërdorimit, riparimit dhe riciklimit të produkteve, duke rritur kështu prodhimin dhe konsumin e qëndrueshëm. Në këtë mënyrë, përveç zvogëlimit të mbeturinave, kursen energji dhe ndihmon në shmangien e dëmeve të pakthyeshme të shkaktuara për sa i përket klimës dhe biodiversitetit, si dhe për sa i përket ndotjes së ajrit, tokës dhe ujit, për shkak të përdorimit të burimeve në një normë që tejkalon mundësinë dhe kapacitetin e tokës për t'i ripërtërirë ato.

Për të zbutur pasojat e mundshme mjedisore, është e nevojshme të minimizohet gjenerimi i mbeturinave dhe të inkurajohet përdorimi i produkteve, materialeve dhe burimeve që do të qëndrojnë në ekonomi për një kohë sa më e gjatë të jetë e mundur. Këto janë bazat e së ashtuquajturës ekonomi qarkulluese e cila kërkon një model të ri të prodhimit dhe konsumit të mallrave dhe shërbimeve të shoqëruara me qëndrueshmërinë dhe mundësi ripërdorimi.

Shoqëria në tërësi mund dhe duhet ta ndihmojë ekonominë qarkulluese të bëhet një realitet i përhapur në tërë botën. Për shembull, Britani e Madhe ka krijuar Synimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm për të siguruar konsum të qëndrueshëm dhe zhvillim të modeleve të prodhimit. Këto synime janë ambicioze dhe universale, të përcaktuara si një thirrje për veprim, kështu që sfidat kryesore mjedisore, sociale dhe ekonomike me të cilat përballet planeti mund të adresohen përmes këtyre synimeve. Vënia në praktikë e shprehjes 'asgjë nuk ka për të humbur, gjithçka transformohet' është një mënyrë e mirë për ta bërë pjesë të jetës sonë duke e parë që burimet çdo ditë e më shumë po humbin dhe nuk po rigjenerohen më.

Një ekonomi qarkulluese është pjesë e zgjidhjes për emergjencën tonë globale të klimës - një në të cilën produktet, shërbimet dhe sistemet janë krijuar për të maksimizuar vlerën e tyre dhe për të minimizuar mbeturinat.

Ky sistem është një qasje gjithëpërfshirëse për jetën dhe biznesin, ku gjithçka ka vlerë dhe asgjë nuk harxhohet kot. Në terma të thjeshtë, ai mund të shpjegohet si 'bëje, përdore, rishfrytëzoje' në krahasim me "bëje, përdore, hidhe".

Ekonomia qarkulluese synon eliminimin e mbetjeve përmes krijimit të produkteve dhe modeleve të biznesit. Thelbi i saj është të projektojë produkte përmes mbetjeve që lehtësojnë çmontimin dhe ripërdorimin.

EKONOMIA QARKULLUESE




Figura 1. Ekonomia qarkulluese

Punoi : KadriCikaqi

Ideja e fillim - fund (Remaking the Way We Make Things) e zhvilluar nga kimisti Michael Braungart dhe arkitekti William McDonough renditet si njëri nga revolucionet më të rëndësishme industriale.

Tradicionalisht slogani kryesor i mjedisit ka qenë "Ulja e ndotjeve, ripërdorimi i produkteve, riciklimi i mbetjeve". Autorët propozojnë një qasje tjetër: "Ulja e ndotjes është e vështirë të

arrihet , por ngadalsimi i saj është mjaftë i rëndësishëm”. Optimizoni projektin dhe prodhimin arkitektonik dhe industrial. Projektioni ide të prodhimit për të mos ndotur fare mjedisin.

2.1.1 Pse na duhet ekonomia qarkulluese

Popullsia e botës pritet të arrijë kulmin në 10 miliardë njerëzve në 2050. Burimet tona, lëndët e para të tokës, nuk janë të pakufishme për dallim nga nevojat. Si rezultat, kostot globale të punës dhe lëndës së parë janë në rritje e sipër.

Mundësitë e biznesit me ekonomi qarkulluese mund të ofrojnë mënyra të reja për të zbutur këto rreziqe dhe për të lejuar bizneset të rriten dhe të diversifikohen. Në një ekonomi qarkulluese, produktet dhe materialet vazhdojnë të qarkullojnë në një gjendje përdorimi me vlerë të lartë, përmes zinxhirëve të furnizimit, për aq kohë sa të jetë e mundur jetëgjatësia e tyre.

Për këtë arsye, "t'i bësh gjërat të zgjasin" është një domosdoshmëri morale, mjedisore dhe ekonomike.

Bizneset, organizatat dhe industritë duhet të përqafojnë mundësitë dhe përfitimet e një ekonomie qarkulluese në mënyrë që mbeturinat të 'projektohen' nga mënyra se si jetojmë - ata që mund ta bëjnë këtë të parët do të kenë një avantazh konkurrues me ata që përqafojnë ekonomin lineare.

Një ekonomi qarkulluese arrihet duke dizenuar produkte me zgjuarsi me gjithë ciklin e tyre të jetës, duke ri-përdorur dhe riparuar ato për të zgjatur jetën e tyre dheshtuar dobinë, pastaj kur jeta e tyre vlerësohet e përfunduar, riprodhimi për të krijuar produkte të reja nga të vjetrat po konsiderohet domosdoshmëri në mungesë të burimeve.

Ka disa rrugë për të përqaftuar një ekonomi qarkulluese duke përfshirë;

Projektimi

Produktet janë krijuar duke përdorur materiale rigjeneruese dhe teknika modulare të dizajnit në mënyrë që të jenë më të thjeshta dhe më të lehta për tu çmontuar dhe riparuar, në thelb, për të projektuar zhdukjen e mbeturinave dhe mbetjeve;

Ripërdorimi dhe riparimi

Ciklet e jetës së produktit zgjaten nga mirëmbajtja dhe riparimi, kështu që ato qëndrojnë në përdorimin e tyre origjinal për aq kohë sa të jetë e mundur. Kjo mund të përfshijë që prodhuesit të mbajnë pronësinë e produkteve të tyre dhe zbatojnë ri-përdorimin dhe shërbimet e riparimit;

Riciklimi

Produktet mund të ndahen lehtësisht në pjesë përbërëse dhe materiale, duke mundësuar përdorimin në produkte të reja, duke zhvendosur përdorimin e lëndëve të para të papërdorura;

Prodhimtaria

Prodhimi i produkteve me parime të ekonomisë qarkulluese të ndërtuara sipas një model të planifikuar paraprakisht;

Riprodhimi dhe ripërdorimi

Zgjatja e jetëgjatësisë së produkteve në fund të ‘jetës së tyre të parë’ duke i rivendosur ato ose duke ju mundësuar përdorime të tjera pasuese;

Modele biznesi përfshirë qiradhënien dhe shërbimin;

Mbikëqyrja e jetëgjatësisë së plotë të produkteve tuaja krijon një model biznesi vërtet të qëndrueshëm, me të ardhura të qëndrueshme.

Çdo biznes është i ndryshëm. Kalimi në një model biznesi rrethor nganjëherë mund të ketë të bëjë me disa ndryshime të vogla që mund të bëjnë një ndryshim të madh në planin afatgjatë.

2.1.2 Objektivat e ekonomisë qarkulluese

Zhvillimi i një sistemi rrethor ekonomik ka disa qëllime. Së pari, kapitali natyror, i cili është rrjedha e burimeve natyrore, duhet të ruhet ose të rritet, duke siguruar kështu përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në vazhdimësi. Kjo arrihet duke kontrolluar rezervat e burimeve të fundme dhe duke balancuar flukset e burimeve të rinovueshme.

Së dyti, rendimentet e burimeve duhet të maksimizohen duke qarkulluar produkte brenda sistemit qarkullues ekonomik. Rendimentet maksimale të burimeve mund të arrihen përmes riciklimit dhe sigurimit që produktet e prodhuara të jenë me cilësi më të lartë të mundshme.

Së treti, mbeturinat mund të eliminohen përmes modelit të produkteve që mund të çmontohen dhe të ripërdoren. Eliminimi i mbetjeve nga sistemet e prodhimit do të thotë që të bëhet më e rëndësishme të sigurohet që materialet e konsumit janë jo toksike ose mund të jenë potencialisht të dobishme kur kthehen në biosferë.

Përndryshe, mallrat me qëndrueshmëri më të lartë dhe përbërje të fortë përmbajnë metale dhe plastika të papërshtatshme për t'u kthyer në biosferëprandaj duhet të projektohen për të siguruar ripërdorimin e suksesshëm.

Ridizajnimi i sistemit për të eliminuar mbeturinat nuk duhet të kufizohet në modelimin e produkteve, por mund të shtrihet edhe në proceset e prodhimit të produkteve të përdorura.

Së fundmi, energjia e përdorur për të nxitur ciklin duhet të ripërtërihet për të siguruar që varësia e burimeve të ulëta dhe qëndrueshmëria e sistemit të rritet. Prandaj, modelet qarkulluese ekonomike vlerësojnë çështjet e biomasës dhe prodhimit të energjisë, menaxhimin e mbeturinave, përdorimin e plehrave, ujit dhe humbjen e ushqimit.

2.1.3 Ekonomia qarkulluese nëfermat bujqësore

Bujqësia është lëmi unike në kuptimin që sektori varet nga burimet natyrore dhe ciklet si inpute kryesore për prodhimin e bimëve dhe blegtorisë. Nivelet e larta të mbështetjes në burimet natyrore dhe ciklet mund të minojnë qëndrueshmërinë e sistemeve natyrore që mbështesin prodhimin bujqësor. Efikasiteti i përdorimit të burimeve dhe ripërdorimi i produkteve të konsumit janë një mënyrë për t'i bërë modelet e biznesit bujqësor më të qëndrueshëm.

Kalimi drejt një ekonomie qarkulluese brenda bujqësisë kërkon një largim nga përdorimi i lëndëve ushqyese teknike drejt përdorimit të lëndëve ushqyese biologjike. Kjo lëvizje drejt lëndëve ushqyese biologjike mund të shihet në Evropë me përqëndrimin e shtuar në zhvillimin dhe përdorimin e biogazit dhe plehrave organike.

Ekzistojnë disa mundësi për zhvillimin e një sistemi qarkullues bujqësor. Mundësia e parë qëndron në krijimin e një sistemi bujqësor rigjenerues që ruan integritetin e sistemit natyror. Sistemi përdor praktika të tilla si rotacioni i të korrave, prodhimi minimal dhe mbulesa e prodhimit. Blegtorja dhe prodhimi i të mbjellave shpesh kombinohen për të krijuar sythe ushqyese shtesë.

Bujqësia rigjeneruese bazohet në parime të tilla si ruajtja e shëndetit të tokës, përdorimi minimal i pesticideve dhe plehrave inorganike, dhe kombinimi i prodhimeve bimë dhe belgtorale. Si rezultat, disa nga faktorët kryesorë të rrezikur me të cilin përballen bujqësia aktuale tregtare janë për shkak të degradimit të kapitalit natyror, ndryshimeve klimatike, çmimeve të paqëndrueshme të inputeve dhe pasiguri për rezultate afatgjate.

Bujqësia “precize” mund të rrisë efikasitetin e sistemeve bujqësore konvencionale dhe të tregojë potencial të lartë për ndërthurjen e këtyre praktikave. Përdorimi i të dhënave bujqësore, mbajtja e shënimeve në fermë, ndryshueshmërinë e kulturës dhe të dhënave mjedisore në kohë reale mund të optimizojë rendimentet, duke ulur kështu eksternalitetet mjedisore.

Rritja e prodhimit dhe shtimi i konsumit të ushqimit përmes bujqësisë peri-urbane zvogëlon transportin e ushqimit dhe kostot shoqërore (të tilla si mbeturinat e ushqimit, karburantit dhe ndikimet e jashtme mjedisore). Teknikat e specializuara të bujqësisë urbane (bujqësia vertikale, hidroponia dhe akuaponia) mund të jenë më efektive në burime duke kursyer energji, ujë dhe pleh.

2.2.Ekonomia lineare

Ekonomia lineare është një model tradicional i bazuar në qasjen ‘marrë-bëj-konsumoj-hudhë’ në përdorimin e burimeve. Lënda e parë shndërrohet në një produkt dhe pasi të përfundojë ciklin e saj jetësor hidhet në mbeturina. Ajo që ekspertët e dinë me siguri është se nëse modeli nuk zëvendësohet, bota do t'i afrohet një pike kthese ku do të humbasë aftësinë për të mbajtur veten dhe për të rigjeneruar burimet e kufizuara.

Kalimi nga ekonomia lineare në atë qarkulluese kalon përmes qasjes së ekonomisë së ripërdorimit.

Modeli shton një lidhje të re në qasjen e ekonomisë lineare. Lëndët e para shndërrohen në një produkt që riciklohet kur përfundon ciklin e tyre të jetës në një produkt të ri, por pas kësaj faze, hidhet dhe nuk ripërdoren.



Figura 2.Ekonomia lineare

Punoi : KadriCikaqi

Qëllimi i ekonomisë qarkulluese për dallim nga ajo lineare është parandalimi i mbeturinave dhe shfrytëzimi i mbetjeve. Prodhuesit kanë dizajn të produkteve të ripërdorshme dhe kur një produkt

i ri është i nevojshëm, ai duhet të merret në mënyrë të qëndrueshme. Prandaj, kur lënda e parë hyn në cikël, ajo duhet të ndjekë ciklin e *prodhimit – përdorimit – riciklimit-prodhimit*.

Ekonomia rrethore është më fitimprurëse dhe më pak e dëmshme për mjedisin dhe qëllimet e saj kryesore përfshijnë rritjen e qëndrueshme ekonomike, rritjen e konkurrencës dhe vendet e reja të punës.

Ekonomia rrethore ka nevojë për përpjekje të përbashkëta nga sipërmarrësit, studiuesit, industrinë, përdoruesit, qeveria, shoqëria civile, ligjvënësit, por mbi të gjitha ka nevojë për inovacion. Ju mund të promovoni ndryshime aq të nevojshme në shoqërinë tuaj nëse mësoni se si të mendoni në mënyrë inovative.

Argumentet për rritje, pabarazi dhe varfëri të vazhdueshme, ndryshimi i klimës dhe burimet e fundme kërkojnë politika më të forta të Zhvillimit të Qëndrueshëm, si nga vendet e zhvilluara ashtu edhe nga vendet në zhvillim. Mund të konceptohen situata me qëndrueshmëri pak a shumë (jo) që inkurajojnë idenë e gjetjes së mënyrave të arsyeshme nga dëshira e njerëzimit për përparim.

Një nga këto, të cilat kohët e fundit janë shfaqur, është "prosperiteti pa rritje" (Jackson, 2009). Bazuar në kuptimin që dyshimi në dogmën e rritjes është një akt i çmendurish, idealistë ose revolucionarë, Tim Jackson këmbëngul se rritja duhet të vihet në dyshim. "Ideja e një ekonomie jo në rritje mund të jetë anatemë për një ekonomist. Por ideja e një ekonomie në rritje të vazhdueshme është një anatemë për një ekolog" (Jackson, 2009).

Tim Jackson (2009) merr linjën e mendimit të nisur nga Klubi i Romës në vitet 1970, duke riafirmuar pamundësinë fizike të ekonomisë sonë për t'u zgjeruar pafundësisht në një planet të fundëm për arsyen e thjeshtë se ekonomia ushqehet nga burimet fizike. Dilema do të jetë midis rritjes së qëndrueshme dhe rritjes së paqëndrueshme.

Një tjetër alternativë e mundshme për paradigmen e rritjes ekonomike është "zbritja e qëndrueshme" (Schneider&Williams; 2011), bazuar në premisën që rritja ekonomike nuk është sinonim i rritjes së cilësisë së jetës e as nuk është e qëndrueshme ekologjikisht. Ajo lind në këtë kontekst të pashmangshmërisë së shkaktimit të dëmeve ekologjike nëse nuk bëhet asgjë për të ndaluar hovin e rritjes ekonomike ose për arritjen e një proporcioni të drejt në mes ruajtjes ekologjike dhe rritjes ekonomike.

Ekonomia botërore në fillim të shekullit të 21-të bazohet kryesisht në shndërrimin e burimeve natyrore në mbetje përmes prodhimit: mallrat prodhohen dhe më pas hidhen si mbeturina, duke përkeqësuar mjedisin. Kjo quhet Ekonomi Lineare dhe megjithëse riciklimi është zhvilluar plotësisht në shoqërinë tonë dhe inkurajohet përmirësimi i efikasitetit të burimeve, aktivitetet e përqendruara në arritjen e efikasitetit dështojnë të marrin në konsideratë se natyra është e fundme dhe burimet janë të kufizuara.

Këto realitete kërkojnë një zhvendosje të paradigmës, ku një përpjekje është e nevojshme për të zëvendësuar konceptin e fundit të jetës me zvogëlimin, ripërdorimin, riciklimin dhe rikuperimin e materialeve (4R) dhe për të ngadalësuar, mbyllur dhe ngushtuar sythet e materialit dhe energjisë. Ky koncept njihet si Ekonomia Qarkulluese. Kalimi nga një sistem linear në atë qarkullues do të kërkojë angazhim nga tre aktorë kryesorë socialë: administrata publike, kompanitë dhe qytetarët (Moyano&Paniagua, 2018).

Sfidat e kalimit nga një sistem linear në atë qarkullues bazohen në tre parime:

- (1) mbrojtja dhe rritja e kapitalit natyror duke kontrolluar rezervat e fundme dhe duke balancuar flukset e burimeve të rinovueshme;
